



Pranimar / Dorezuar Prmijeno / Predato Received / Delivery	22. 10	2020	0	viti god. year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMBICK	2221/2020		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.246/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga Jeton Koca - kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar, dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën numër A. nr.246/2020 të datës 25.08.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi rruga "Vlora", Nr.9, Fshati Seqishtë, Komuna e Hanit të Elezit, kundër organit të punësimit - Komuna e Hanit të Elezit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.10.2020, mori këtë .

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër protokolli A.nr.246/2020 e datës 25.08.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli 02/Nr.4624/2020 i datës 11.08.2020 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Hanit të Elezit.

III. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komuna e Hanit të Elezit, bazuar në autorizimin e datës 26.06.2020 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, me datë 30.06.2020 ka shpallur konkurs publik për pozitën e punës "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [REDACTED]. Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Hanit të Elezit, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, me datë 24.07.2020 ka shpallur njoftimin me numër 02/Nr.4514/2020 lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1".

Kandidati, Jenuz Berisha i pakënaqur me përzgjedhjen përfundimtare, me datë 29.07.2020, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa në Komunën e Hanit të Elezit.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 11.08.2020 ka nxjerr vendimin me numër 02/Nr.4624/2020 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Kundër Vendimit me numër 4624/2020 të datës 11.08.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Ankuesi ██████████ brenda afatit të përcaktuar ligjor, me datë 25.08.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1615/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.09.2020 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankese në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa kjo e fundit me datë 16.09.2020 e ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankese me të gjitha shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Autorizimin e datës 26.06.2020 për publikimin e konkursit nga Ministria e Administratës Publike: Konkursin e shpallur në gazetën Zëri: Ankesën me numër të protokollit 1615/2020 të datës 25.08.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Vendimin me numër 4224/2020 të datës 11.08.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Hanit të Elezit; Formulari për punësim i datës 06.07.2020: Vërtetimin e datës 20.12.2018: Certifikatën me numër 03/2662 të datës 24.09.2014: Vendimin me numër 6/691 të datës 03.02.2012: Diplomën Universitare me numër 12-979-04/2651 të datës 28.06.2010: Vërtetimin e datës 06.07.2020: Cv e kandidatit Jenuz Berisha: Kërkesën për përgjigje në ankese me numër të protokollit 1665/2020 të datës 01.09.2020: Përgjigjen në ankese me numër të protokollit 1771/2020 të datës 16.09.2020: Njoftimin e datës 24.07.2020 për kandidatin e përzgjedhur: Form.MAP-SHCK-11 Raportin Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues: Form.MAP-SHCK-10 Renditja përfundimtare e kandidateve: Form.MAP-SHCK-09 Përmbledhja e Vlerësimeve Individuale: Form.MAP-SHCK-07a Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj: Form.MAP-SHCK-04 Regjistri i kandidateve të cilët janë futur në listën e ngushte dhe të ftuar në testin me shkrim: Form.MAP-SHCK-05 Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushte: Form.MAP-SHCK-04; Regjistri i aplikacioneve të pranuar: Form.MAP-SHCK-08a; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj: Testi me shkrim i datës 01.07.2020: Njoftimi i datës 20.07.2020 lidhur me testin me shkrim: Vlerësimi për përfshirje në listën e ngushte: Njoftimi me numër 4517/2020 mbi të drejtën për emërim: Testi me shkrim i kandidateve të përzgjedhur: Diploma me numër 5876 e datës 09.02.2018 e kandidateve Jetmire Sopa: Vendimi me numër 3267/2018 i datës 19.04.2018 për miratimin e listës për tri komunitetet konsultative: Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 06.05.2019: Akte Emërimi i datës 30.12.2011: Akte Emërimi i datës 04.02.2013: Ndryshimi dhe plotësimi i akte emërimit i datës 10.06.2019: Akte emërimi i datës 30.12.2011: Ndryshimi dhe plotësimi i akte emërimit i datës 23.04.2018: Akte emërimi i datës 16.07.2012: Akte emërimi i datës 01.09.2014: Vendimi me numër 4154/2020 i datës 14.07.2020 për formimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil: Propozimi i datës 14.07.2020 për formimin e Komisionit Përzgjedhës për Shërbyes Civil: Deklarata e datës 14.07.2020 rreth formimit të KPMSHC: Konkursi me numër 3560/2020 i datës 30.06.2020: Kërkesa me numër të protokollit 2096/2020 e datës 14.10.2020 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit Jenuz Berisha:

Vendimi me numër të protokollit 2097/2020 i datës 14.10.2020 për vazhdimin e afatit për vendosjen edhe për dhjete (10) dite pune për ankesën me numër A.nr.246/2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit ██████████, është e pa bazuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në konkursin e shpallur me datë 30.06.2020 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1" në Komunën e Hanit të Elezit, kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Diploma Universitare: Fakulteti i Sociologjisë, Psikologjisë, Pedagogjisë, apo Drejtësisë;*
- *Te ketë aftësi të mira komunikimi dhe nder personale.*

Lidhur me pretendimet ankimor të ankuesit se në konkursin e datës 30.06.2020 për pozitën "Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1" bëhet fjalë për punësim familjar dhe nepotizëm, sepse sipas ankuesit ai i plotëson kriteret me mire se kandidatja e përzgjedhur për shkakun se ajo është e sapo diplomuar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson së procedura e rekrutimit nga Komuna e Hanit të Elezit, është zhvilluar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se KPSHC ka vlerësuar aplikacionet e paraqitura dhe ka përgatit listën e shkurt konform nenit 28 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur Jetmire Sopa, ka të përfunduara studimet themelore-bachelor në Sociologji në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" andaj e njëjta e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në konkurs. Kandidatja Jetmire Sopa në testin me shkrim dhe intervistën me goje ka mbledhur me se shumti pike, andaj, Kolegji vlerëson së KPSHC me rastin e përzgjedhjes së kandidatës Jetmire Sopa, si kandidate me më se shumti pikë të mbledhur në testin me shkrim dhe intervistën me goje, ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë".

Lidhur me pretendimin ankimor se anëtarët e Komisioni Përzgjedhës kanë pasur konflikt interesi, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi në shkresat e lëndës nuk ka dorëzuar asnjë shkresë apo kërkesë përmes të cilës ka kërkuar përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit Përzgjedhës, siç përcaktohet me nenin 30 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj ketë pretendim e konsideron si të pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor së testi me shkrim është manipuluar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse pala ankuese nuk ka ofruar asnjë prove që mbështet pretendimin e tij, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës vërehet se përmbajtja e testit me shkrim dhe vlerësimi ka qenë në përputhje me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Hanit të Elezit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit



02/Nr.4624/2020, të datës 11.08.2020, ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.


*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.246/2020*

Ilire Mehmeti - Shaqiri


Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, 
- Kryetarit të Komunës të Hanit të Elezit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Hanit të Elezit; dhe
- Arkiviot të KPMSHCK-së

